



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1384/1 prot.

Tiranë, më 18.11.2025

V E N D I M

Nr. 264, datë 18.11.2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 220 Regj., datë 02.10.2025, e shtetasës I. M, kundër Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me pretendim diskriminimin për shkak të “*gjinisë, gjendjes ekonomike, gjendjes familjare, gjendjes martesore dhe çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar si vijon:

“Unë I. M paraqes këtë ankesë kundër Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si institucion publik, në lidhje me diskriminimin dhe riviktimizimin që kam pësuar nga mënyra e trajtimit në vendimin e dhënë mbi çështjen gjyqësore me nr. 30 (13-2024-124), datë 17.01.2024.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Aktualisht kjo çështje është në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe ka për objekt vetëm pronësinë e apartamentit ku unë kam jetuar për mbi 30 vite me ish-bashkëshortin dhe tre fëmijët tanë. Ankesa që unë paraqes në KMD, nuk ka për qëllim të ndikojë në procesin gjyqësor për pronësinë, por të shqyrtojë aspektin e diskriminimit dhe riviktimizimit që është kryer ndaj meje përmes gjuhës dhe arsytimit të përdorur në vendimin e shkallës së parë. Pra, me pak fjalë, ankesa është e drejtuar për diskriminim nuk ka qenë dhe nuk është objekt padie dhe ankimi.

Me vendimin nr. 180, datë 11.02.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kam zgjidhur martesën me ish-bashkëshortin G. T, për shkak të dhunës së tij, gjë për të cilën kam qenë e pajisur disa herë me urdhra mbrojtjeje, me afat 1 vjeçar dhe 6 mujor.

Në tetor të vitit 2020, kam hapur një proces gjyqësor në Gjykatën e Elbasanit me objekt: “Detyrimin e të paditurit të më njohë bashkëpronare për apartamentin që unë posedoja prej 30 vitesh.

Me vendimin nr. 30, datë 17.01.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, vendosi: “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova e ligj.”

Vendimi i Gjykatës përdor gjuhë diskriminuese dhe stereotipe gjinore, duke nënvlerësuar rolin tim si bashkëshorte dhe nënë.

Kështu, në faqen 24, paragrafi i parë e në vijim të vendimit, ka një gjuhë diskriminuese dhe patriarkale, si më poshtë:

“Pra në këtë mënyrë sqarohet edhe një rrethanë shumë e rëndësishme se si është vendosur paditësja në atë banesë si bashkëshortja e shtetasit G. T.” Ky arsyetim tregon se Gjykata e vlerëson paditësen në banesë përmes lidhjes së saj martesore me burrin, duke mos njohur të drejtat e saj individuale, gjë që përbën një qasje diskriminuese dhe patriarkale.

Vendimi i Gjykatës ka përmbajtje thelbësisht diskriminuese kur deklaroi se: “Paditësja me kërkesë padinë që ka paraqitur kërkon të marrë padrejtësisht dhe pa pagesë pasurinë e H. T (ish-vjehrrin)... vetëm ai e gëzon të drejtën për ta përfutur atë.”

Kjo frazë i mohon paditëses çdo subjektivitet të pavarur juridik, duke i reduktuar të gjitha të drejtat e saj në raport me një mashkull (ish-vjehrrin dhe ish-bashkëshortin) duke e përjashtuar faktin se ajo ka jetuar, kontribuar, ka pasur gjendje strehimi dhe ka qenë dhe është poseduese e banesës.

...

Paditësja I. M është një grua e mbijetuar nga dhuna në familje dhe është e detyruar të sigurojë strehim dhe stabilitet për veten dhe fëmijët e saj pas ndarjes. Këmbëngulja për të mohuar të drejtën e saj, pavarësisht përdorimit të gjatë të banesës dhe statusit, është një akt riviktimizimi nga ana e sistemit të drejtësisë.

...

Përdorimi i termave si “...kërkon të marrë padrejtësisht pasurinë” dhe konsiderimi i paditëses thjesht si “bashkëshortja e G. T”, pa njohur asnjë të drejtë vetjake për privatizim, është tregues i një diskuri juridik me prirje patriarkale dhe maskiliste, që bie ndesh me parimet bazë të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

...

Konfliktet me ish-bashkëshortin dhe zgjidhja e martesës interpretohen si arsye për ta penalizuar, duke mos vlerësuar rolin e saj si nënë e tre fëmijëve.

Ankuesja ndodhet në kushte të vështira ekonomike dhe vendimi i Gjykatës e lë pa strehim, duke mos marrë parasysh vulnerabilitetin e saj ekonomik. Vendimi i Gjykatës ka prodhuar një efekt të qartë diskriminues mbi bazë të gjendjes ekonomike dhe sociale të ankuseses. I, është një grua e divorcuar, e papunë dhe jeton vetëm me të ardhurat nga ndihma ekonomike, pa asnjë strehim alternativ ose mbështetje financiare. Gjykata e ka trajtuar rastin sikur gjendja e saj ekonomike të mos kishte rëndësi, duke e reduktuar pozicionin e saj vetëm në marrëdhënine e dikurshme martesore me ish-bashkëshortin. Kjo qasje thellon pabarazinë dhe e penalizon direkt për shkak të varfërisë, duke e lënë pa mbrojtje efektive.

Gjykata ka dështuar të respektojë standardet e vendosura nga GJEDNJ, (lidhur me detyrimin e autoriteteve për të marrë parasysh rrethanat ekonomike dhe sociale përpara vendimeve që prekin drejtpërdrejtë jetën dhe strehimin e individit) dhe ka legjitimur një praktikë që godet veçanërisht gratë në kushte të vështira.

Më këtë vendim, të mbushur me diskriminim dhe stereotipe gjinore, ankuesja pas një martese 28 vjeçare dhe pasi ka përballuar dhunë dhe përgjashtim, mbetet praktikisht në qiell të hapur, e privuar nga e drejta për strehim dhe nga dinjiteti i saj si grua dhe si qytetare e barabartë.

Dhuna dhe konfliktet përdoren kundër saj nga Gjykata. Shprehje si “...qëndron në atë pasuri me forcë dhe jashtë dëshirës së pronarit” e stigmatizon dhe delegjitimon atë, duke përforcuar stereotipe gjinore.

Fjala e burrave merret si e besueshme, ndërsa përvoja dhe fjalët e ankuseses nuk marrin vlerë, duke reflektuar një qasje patriarkale dhe të njëanshme.

...trajtimi i njëanshëm, gjuha diskriminuese dhe riviktimizimi bien ndesh me të drejtat për jetë private dhe familjare, si dhe një proces të drejtë. Shteti ka detyrim të mbrojë viktimat e dhunës dhe të shmangë penalizimin për shkak të dhunës që kanë përjetuar.

Në përmbledhje të sa më sipër, nëse Gjykata përdor dhunën në familje dhe konfliktet me ish-bashkëshortin si argument kundër ankuseses për të kufizuar të drejtat e saj pronësore, kjo krijon

një precedent jashtëzakonisht të rrezikshëm për të gjitha gratë në Shqipëri. Në praktikë, çdo grua që ka përjetuar dhunë ose keqtrajtim nga bashkëshorti mund të gjendet e penalizuar për faktin që është viktimë, duke e bërë të pamundur mbrojtjen e të drejtave pronësore ose të tjera ligjore. Kjo qasje përbën riviktimizim, legjitimon stereotipe gjinore dhe është në kundërshtim të hapur me standardet ndërkombëtare dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.“

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri:

- *“Konstatimin e diskriminimit gjinor mbi bazë statusi martesor, gjendjes familjare dhe ekonomike.*
- *Konstatimin e riviktimizimit të saj dhe përdorimit të dhunës kundër saj si arsyetim penalizues.*
- *Dhënien e rekomandimeve për gjykatat dhe KLGJ-në për shmangien e gjuhës diskriminuese dhe qasjeve patriarkale.*
- *Marrjen e masave për sensibilizimin dhe trajnimin e trupës gjyqësore mbi barazinë dhe mosdiskriminimin.”*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Lidhur me kërkimin e subjektit ankues për:

- Gjuhën e përdorur gjatë arsyetimit të vendimit nr. 30, datë 17.01.2024 nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si dhe diskriminimin e konsumuar kundrejt saj në këtë vendim;
- Për shkelje nga ana e Gjykatës së të drejtave të saj themelore, të standardeve ndërkombëtare dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, si dhe dështimit të shtetit lidhur me detyrimin për mbrojtjen e viktimave të dhunës dhe shmangien e penalizimit për shkak të dhunës që kanë përjetuar, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Komisioneri evidenton se, ankimimi i vendimeve të organeve gjyqësore, bëhet sipas hierarkisë, në shkallët më të larta të gjykatave respektive dhe se shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar, në nenin 452², të tij, lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, ka përcaktuar se:

“1. Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj”.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, nëse subjekti ankues nuk është dakord me vendimarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me pretendimet e tij, atij i lind e drejta e ankimit të vendimit në Gjykatën e Apelit, bazuar në dispozitat ligjore specifike.

² Neni 452 - “Vendimet që mund të ankimohen”.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”*.

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese³, ndër të tjera, thuhet se: *“Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”*.

Pretendimet e ankueses mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta.

Në nenin 194/1 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim apo kontrolli i vendimmarrjeve të gjykatave, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

³ *“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”*.

⁴ Për analogji citojmë Vendimin nr. 02, datë 11.01.2021 dhe Vendimin nr. 112, datë 22.06.2023, të KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues I. M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA